





UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË	UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJE	
REKTORATI			
Nr. / Br. / No. <u>2172</u>		Nr. i faq/ Br. str / No. pg <u>9</u>	
Date / Datum / Dato: <u>21.09.2022</u> Pejë / Peć			

RRREGULLORE PËR PROGRAME TË STUDIMIT

Shtator 2022

Në bazë të nenit 42, 48, paragrafi 1, pika 1.8 e Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, Senati në mbledhjen e mbajtur me datë 15.09.2022, miraton Rregulloren për Programe të Studimit.

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregullore është përcaktimi i procedurave për iniciimin, hartimin, aprovimin, monitorimin, vlerësimin e programeve të studimit.

Neni 2 Fushëveprimi

Kjo rregullore zbatohet nga Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë, njësitë akademike, stafi, studentët, dhe të gjithë akterët tjerë të cilët bëjnë propozim për programe të reja të studimit, monitorim, vlerësim, apo rishikim të programeve aktuale.

Kapitulli I

Neni 3 Inicimi i programeve të reja

1. Propozimi për iniciim të programeve të reja mund të bëhet nga:
 - 1.1. Menaxhmenti i universitetit;
 - 1.2. Këshilli i njësisë akademike;
 - 1.3. Komisioni i studimeve i njësisë akademike;
 - 1.4. Trupat Këshillëdhënëse;
 - 1.5. Stafi akademik;
 - 1.6. Anëtarët e Alumnit (ish-studentët e UHZ-së);
 - 1.7. Studentët;
 - 1.8. Akterët relevant të jashtëm (bordi industrial, etj).

Neni 4 Detyrat e propozuesve

1. Çdo propozues i paraparë në nenin 3 të kësaj rregullore, për iniciimin e një programi të ri të studimit ka për detyrë që:
 - 1.1. Të hulumtojë tregun e punës;
 - 1.2. Të ketë takime me trupat këshillëdhënës dhe palet tjera të interesit;
 - 1.3. Të bëjë analiza të ndryshme përmes pyetësorëve apo fokus grupeve;
 - 1.4. Te analizoj se a ka programe te ngjashme që ofrohen ne Kosovë;
 - 1.5. Te hulumtojë se a ofrohen programe të ngjashme në Universitetet relevante evropiane (krahasueshmëria).
2. Procedurat e njëjta të lartëcekura vlejné edhe për programet të cilat aplikohet për riakreditim.

Neni 5

Procedura e inicimit

1. Propozuesit e programit të ri të studimit pas konsultimit me Komisionin e Studimeve të njësisë akademike, duhet t'i drejtohen Këshillit të njësisë akademike me një dokument përmbledhës të programit të propozuar, i cili përmban:
 - 1.1. Emërtimi i programit, Niveli, Kreditë, Specializimet (nëse ka), Numri i studenteve, Kodi i Zonës së Subjektit Erasmus (ESAC);
 - 1.2. Qëllimi i programit;
 - 1.3. Misioni (Programi i inicuar duhet të jetë në harmoni me misionin e UHZ-së dhe të njësisë akademike dhe organizative përkatëse);
 - 1.4. Përmbajtja e programit;
 - 1.5. Rezultatet e të nxënit (të paktën 7);
 - 1.6. Të siguroj që ekzistojnë bartësit e kualifikuar të fushës përkatëse, dhe të kenë publikime shkencore të indeksuara, sipas kërkesës së AKA-së.
2. Përpos pikave të cekura në paragrafin 1 të këtij neni, propozuesit duhet t'i përmbahen formularit specifik i cili është pjesë e manualit.
3. Propozuesi ka për obligim t'i bashkangjitë dokumentit përmbledhës të cekur në pikën 1 të këtij neni, dëshmi për çdo hulumtim, analizim apo takim të bërë, sipas paragrafit 1 të nenit 4 të kësaj rregullore.
4. Në rastet kur propozues është vet Këshilli i njësisë akademike, atëherë Këshilli është i obliguar që të formojë një Komision për ndjekjen e procedurave të inicimit sipas kësaj rregullore.
5. Inicuesit duhet të i dorëzojnë propozimet për programe të reja më së largu 45 dite para hapjes së afatit për aplikim në AKA.

Neni 6

Afati kohor për aprovim

1. Këshilli i njësisë akademike pas pranimit të raportit për program të ri apo për program në riakreditim, jo më larg se pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendrike duhet ta shqyrtojë propozimin.
2. Këshilli i njësisë akademike, me vendim mund ta refuzojë apo pranojë propozimin për program të ri apo për program në riakreditim.
3. Pas aprovimit nga Këshilli i njësisë akademike, propozimi për program të ri apo program në riakreditim, shqyrtohet nga KMCV, dhe Senati i cili është organi i vetëm vendimmarrës për aprovim apo jo të propozimit për program të studimit.
4. Në rast të aprovimit, inicuesi jo më larg se tre (3) ditë pune duhet të procedojë në Komisionin e Studimeve në nivel të njësisë akademike, të cilët së bashku me bartësit e programit të caktuar nga Këshilli i Njësisë, do të hartojë programin e studimit.

Kapitulli II

Hartimi i programeve

Neni 7

Hartimi i programeve (Raporti i Vetëvlerësimit)

1. Përgjegjës për hartimin e programeve të studimit janë:
 - 1.1. Bartësit e programeve të studimit, dhe
 - 1.2. Grupi punues i formuar nga Këshilli i njësisë akademike.
2. Detyrat e bartësve të programit janë:
 - 2.1. Udhëheqin me grupin punues për hartimin e programit;
 - 2.2. Analizojnë nevojat e tregut për programin në hartim;
 - 2.3. Marrin pjesë në hartimin e pritjeve mësimore (learning outcomes);
 - 2.4. Përcaktojnë raportin e lëndëve të obligueshme dhe zgjedhore në program;
 - 2.5. Hartojnë tabelaret me përmbajtje të programit sipas standardeve ECTS, të ndërlidhura me pritjet mësimore;
 - 2.6. Organizojnë mesimdhënësit potencial që të hartojnë përmbajtjet e syllabuseve;
 - 2.7. Deri në ditën e vlerësimit nga ekspertët e jashtëm ndërkombëtar, bartësit e programit janë të obliguar të mbajnë simulime me grupe pjesëmarrëse të cilët do të marrin pjesë në takim me ekspertë.
3. Detyrat e grupit punues përcaktohen me vendim në momentin e themelimit.

Neni 8

Dokumentet për hartim të programeve

1. Hartuesit e programit të studimit u përmbahen dokumenteve aktuale në fuqi, të brendshme, si në vijim:
 - 1.1. Statutit të UHZ-së;
 - 1.2. Rregullores për programe të studimit;
 - 1.3. Udhëzuesit për programe të studimit.
2. Të jashtme, si në vijim:
 - 2.1. Udhëzimi Administrativ (MASHT) 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (me të gjitha plotësim ndryshimet e tij);
 - 2.2. Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve;
 - 2.3. Manualin e Agjencisë së Kosovës për Akreditim;
 - 2.4. Shabllonit për hartim të programeve (nga AKA).
3. Pas hyrjes në fuqi të kësaj rregullore, të gjitha plotësim ndryshimet e akteve ligjore, nënligjore, manualeve, apo dokumenteve tjera të nxjerra nga MASHT, AKA, UHZ, e të cilat e rregullojnë këtë fushë, bartësit e programit janë të obliguar të i respektojnë si të ishin paraparë në këtë rregullore.

Kapitulli III

Aprovimi i programeve

Neni 9

Aprovimi i programeve

1. Aprovimi i programeve të UHZ-së, bëhet si më poshtë:
 - 1.1. Aprovimi i brendshëm (nga organet e UHZ-së) dhe
 - 1.2. Aprovimi i jashtëm (nga Agjensia e Kosovës për Akreditim).

Neni 10

Aprovimi i brendshëm

1. Aprovimi i brendshëm duhet të kaloj nëpër organet e UHZ-së.
2. Programi i propozuar duhet të miratohet nga Këshilli i njësisë akademike, si fazë e parë.
3. Pas miratimit nga Këshilli i njësisë akademike, njësia akademike të gjithë dosjen e programit duhet ta përcjellë për shqyrtim në Këshillin për Menaxhim të Cilësisë dhe Vlerësim (KMCV), si fazë e dytë.
4. KMCV, pas analizimit dhe shqyrtimit të dosjes i rekomandon Senatit të UHZ-së për miratim apo jo të atij programi.
5. Senati është organi i fundit vendimmarrës për aprovim apo jo të programeve të studimit në aplikim, e cila është faza e tretë dhe e fundit.
6. E gjithë procedura nga momenti i inicimit e deri në aprovim nga Senati i UHZ-së, duhet të përfundojë më së largu 15 ditë para mbylljes së aplikimit.

Neni 11

Aprovimi i jashtëm

1. Aprovimi i jashtëm i fazës së parë të programit në aplikim bëhet nga Këshilli Shtetëror i Cilësisë (faqja e parë, shtojcat, bartësit).
2. Pas aprovimit nga KSHC, AKA njofton UHZ-në nëse programi është aprovuar apo jo, dhe nga dita e pranimit të njoftimit UHZ duhet të hartojë programin e studimit brenda 30 ditëve, dhe ta dorëzojë në AKA.
3. Në rastet kur KSHC nuk aprovon programet në aplikim, UHZ ka të drejtë ankese sipas këshillës juridike të lejuar në vendim.

Kapitulli IV

Monitorimi i zbatimit të programit të studimit

Neni 12

1. Përgjegjës për monitorimin e programeve të studimit janë:
 - 1.1. Koordinatorët/zyrtarët e cilësisë në NJA;
 - 1.2. Bartësit e programeve;
 - 1.3. Prodekani për çështje mësimore;
2. Monitorimi i programeve të studimit bëhet nga fillimi i vitit akademik dhe në vazhdimësi.

Neni 13

1. Detyrat e përgjegjësve për monitorimin e programeve të studimit janë:
 - 1.1. Monitorimi i bartësve të programit dhe stafit akademik;
 - 1.2. Monitorimi i bartësit të lëndës, sipas planprogramit të akredituar;
 - 1.3. Monitorimi i orareve të ligjëratave dhe ushtrimeve;
 - 1.4. Monitorimi i implementimit të rekomandimeve të ekspertëve;
 - 1.5. Monitorimi i web faqes;
 - 1.6. Kontrollimi i planprogramit të programit sipas akreditimit nga KSHC;
 - 1.7. Monitorimi i vijueshmërisë së mësimit;
 - 1.8. Monitorimi i punës praktike;
2. I gjithë procesi i monitorimit të programit është paraparë në detaje në Udhëzuesin për programe të studimit, i cili është pjesë e kësaj rregullore.

Kapitulli V

Vlerësimi i programeve të studimit

Neni 14

1. Vlerësimi i programit të studimit bëhet nga komisioni ad-hoc në nivel të NJA, i cili zgjedhët nga KMCV, që vepron vetëm në periudhën e kryerjes së vlerësimit të brendshëm të programit.
2. Komisioni ad-hoc ka si detyrë kryerjen e vlerësimit të programit dhe hartimin e raportit të vlerësimit të brendshëm për programin e studimit. Komisioni ad-hoc ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e institucionit.
3. Komisioni ad-hoc kryen vlerësimin e brendshëm sipas procedurave të parapara në këtë Rregullore dhe Udhëzuesin për Sigurim të Cilësisë.
4. Vlerësimi i programit do të bëhet pas çdo dy viteve me kusht që gjatë monitorimit të jetë çdo gjë në rregull.

Neni 15

Instrumentet për vlerësim të programit

1. Komisionet ad-hoc vlerësimin e programeve mund ta bëjnë, por pa u kufizuar, përmes:
 - 1.1 Pyetësorëve me studentë, alumni, punëdhënës, etj;
 - 1.2 Përmes fokus grupeve;
 - 1.3 Përmes analizimit të statistikave për fushat përkatëse të programit, dhe vlerësimeve të tjera, si në vijim:
 - 1.3.1. Evidentim të pjesëmarrjes së studentëve në ligjërata;
 - 1.3.2. Kalueshmëria e studentëve;
 - 1.3.3. Vlerësim të syllabusëve
 - 1.3.4. Regjistrimi i studentëve në raport me numrin e shpallur për aplikim, dhe formave të tjera, varësisht nga programi i vlerësuar;
 - 1.3.5. Vlerësim të shpërndarjes së kredive nëpër lëndë;
 - 1.3.6. Vlerësim të lëndëve mësimore;
 - 1.3.7. Vlerësim të elementëve tjera (ligjërata, punime seminarike, praktika, projekte, laboratorë, etj);
 - 1.3.8. Vlerësim të literaturës së përdorur, mungesat e vërejtura dhe masat për përmirësim të situatës;
 - 1.3.9. Vlerësim të implementimit të programit dhe planprogramit të studimit në vitin përkatës akademik;
 - 1.3.10. Vlerësim i feedback-ut të marrë nga vlerësimi i bërë me studentë, punëdhënës, industrinë etj.

Neni 16

Raportet e vlerësimit të programit

1. Komisioni ad-hoc pas realizimit të vlerësimit të programit do të hartojë raport me të gjeturat nga vlerësimi.
2. Raportin përfundimtar me rekomandime komisioni duhet ta përcjellë në KMCV, përmes Zyrës për Sigurim të Cilësisë dhe Vlerësim.
3. KMCV, jo më vonë se 7 ditë pune pasi të jetë njoftuar nga zyra do ta shqyrtoj raportin e pranuar nga komisioni ad-hoc, dhe varësisht nga të gjeturat në vlerësim do të japë rekomandime për përmirësim, rishikim apo vazhdimësi të programit.
4. KMCV, raportin me rezultate të vlerësimit dhe rekomandime për përmirësim ia përcjellë Menaxhmentit të lartë të universitetit, Dekanit të njësisë akademike, Bartësve të programit, Zyrës për Sigurim të Cilësisë dhe Vlerësim, Zyrës për Mësimdhënie dhe Çështje Akademike, duke rekomanduar Rektorin për veprimet që duhet të ndermerren.

Kapitulli VI

Rishikimi i programeve të studimit

Neni 17

1. Rishikimi i Programeve në UHZ bëhet çdo dy-katër vite, para periudhës së aplikimit për riakreditim me propozim nga:
 - 1.1. Komisioni ad-hoc pas vlerësimit të programit të studimit;
 - 1.2. KMCV.
2. Akterët që mund t'i propozojnë KMCV-së në çdo kohë formimin e komisioneve ad-hoc për vlerësim që shpije deri te Rishikimi i Programeve të Studimit janë:
 - 2.1. Rektori;
 - 2.2. Senati;
 - 2.3. Udhëheqësi i programit të studimit;
 - 2.4. Dekani i njësisë përkatëse;
 - 2.5. Këshilli i njësisë akademike.

Neni 18

1. Në rast se komisioni ad-hoc pas vlerësimit të programit ka konstatuar se një program i caktuar ka rezultuar me ngecje apo është evidentuar që duhet të ketë përmirësime, KMCV njofton Dekanin e njësisë akademike përkatëse, i cili përmes Këshillit të njësisë akademike formon grupin punues të bëjë rishikim të programit. Në grup punues përfshihen bartësit e programit, komisioni i studimeve në nivel të njësisë akademike, studentë dhe akterë të jashtëm.
2. Grupi punues, përveç fushave të rekomanduara për rishikim nga komisioni ad-hoc, do të rishikoj edhe:
 - 2.1. Misionin, objektivat dhe administrimin e programit;
 - 2.2. Menaxhimin e cilësisë (rezultatet nga pyetësorët);
 - 2.3. Stafin akademik;
 - 2.4. Përmbajtjen e procesit arsimor;
 - 2.5. Studentët;
 - 2.6. Hulumtimin;
 - 2.7. Infrastrukturën dhe burimet;
 - 2.8. Rekomandimet e dhëna nga ekspertët e jashtëm të AKA-së.
3. Sipas Manualit të AKA-së, gjatë periudhës së akreditimit të vendosur nga AKA për një program, universiteti mund të kryejë ndryshime në nivelin e një programi studimi brenda kufirit prej 35%. Ndryshimet që tejkalojnë këtë përqindje përbëjnë një program të ri dhe prandaj do të kërkohet që t'i nënshtrohen një procedure të re akreditimi.

Neni 19

1. Grupi punues për rishikim të programit duhet të respektojë standardet akademike sipas Manualit për Akreditim dhe Ligjin për Arsimin e lartë në Republikën e Kosovës, Statutin e Universitetit, dhe dokumentet tjera relevante.
2. Grupi punues, në afat prej 30 ditë, programin e rishikuar dhe të përmirësuar duhet ta dërgojë në Këshillin e njësisë akademike.
3. Këshilli i njësisë akademike, pas aprovimit, programin e rishikuar e përcjellë në KMCV, ndërsa pas shqyrtimit KMCV e përcjellë për miratim në Senat.

Neni 20

1. Të gjitha afatet e parapara në këtë rregullore janë sipas ligjislacionit në fuqi, dhe në rast të ndryshimeve eventuale të gjithë akterët janë të obliguar që t'i zbatojnë afatet e reja.
2. Pjesë e veçantë e kësaj rregullore është Udhëzuesi për Programe të Studimit.

Neni 21

Hyrje në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Senati i Universitetit.

Kryesues i Senatit të UHZ-së
Prof. Dr. Armand Krašniqi

